



Vlerësim Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i Universitetit “New York” të
Tiranës**

Qershor 2017

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1	Profesor Edward J Esche	Kryetar
2	Profesor Andy Cobb	Anëtar
3	Profesor Raimonda Duka	Anëtare

Përmbajtja

Përmbajtja	3
Rreth këtij vlerësimi	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur.....	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	6
Raporti i detajuar	8
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij.....	8
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	13
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	16
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	21
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	27
Lista e dokumenteve	31

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga APAAL-i. Grupi i vlerësimit drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si IAL-ja i përmbush standardet. Gjithashtu, ky raport, i ndihmon IAL-të të identifikojnë prioritetet për përmirësime (procesi që ofruhet e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikës së mirë, rekomandimet, pohimet e veprimeve të ndërmarra dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti Nju Jork i Tiranës (UNYT) u themelua në vitin 2002. Ai është i vetmi kolegji i arteve të lira i stilit amerikan në Shqipëri. Nga UNYT-ja janë diplomuar mbi 1,000 studentë, të cilët, aktualisht, po krijojnë karriera të suksesshme në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, jo vetëm si njerëz profesionistë të biznesit, por edhe si sipërmarrës profesionistë. Disa prej tyre janë duke vazhduar karrierën akademike brenda dhe jashtë Shqipërisë.

UNYT-ja është një universitet jopublik, që ofron programe studimi Bachelor katërvjeçare të tipit amerikan. Institucioni dhe programet e tij specifike u akredituan në vitin 2006, ndërsa në vitin 2015, u riakredituan. Programet e studimit u riorganizuan dhe u akredituan për të ofruar diplomë të integruar të nivelit të dytë në vitin 2007 dhe Master Profesional në vitin 2010.

Programi i integruar i Masterit të Shkencave në Drejtësi u licensua në vitin 2009. Të gjitha programet e tjera, krahas Masterit të Shkencave në Drejtësi, që u zhvillua në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich-it, veprojnë në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të "New York Empire State College" dhe Universitetin e Boltonit. Programi i Masterit në Administrim Biznesi, që është i barasvlershëm me Masterin e Shkencave, u licencua fillimisht në vitin 2008. U hartuan tre programe të tjera diplomimi, të cilat u vunë në funksion në bashkëpunim me Universitetin e Greenwichit: Master në Drejtësi në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare, Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike dhe Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare. Ato u licencuan në vitin 2012 dhe 2013. UNYT-ja është njohur si universitet, që prej vitit 2012. Gjithashtu, që prej këtij viti ai ka ofruar edhe programe doktorate në Administrim Biznesi, Shkenca Kompjuterike, si dhe në Shkenca Humane dhe Shkenca Sociale, të cilat aktualisht janë në proces vlerësimi për akreditim.

Raport i përmbledhur

UNYT-ja është një universitet jopublik, godinat e të cilit ndodhen në Tiranë. Ai ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në gjuhën angleze, si dhe programe të ciklit të parë në gjuhën shqipe. Universiteti përbëhet nga dy fakultete: Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, si dhe Fakulteti i Drejtësisë, Artit dhe Shkencave. Misioni i UNYT-së është t'iu ofrojë studentëve mundësinë për marrjen e një diplome universitare të nivelit Bachelor, Master ose Doktorate në një shumëllojshmëri specializimesh akademike dhe profesionale, që do t'iu ofrojnë atyre njohuritë, aftësitë, transparencën dhe besimin e nevojshëm për arritjen e suksesit, në një ambient pune të larmishëm dhe ndërkombëtar, si dhe do t'i përgatisin për jetën si qytetarë produktivë e kontribues të komunitetit ndërkombëtar. Këtë gjë e realizon përmes katër departamenteve (Departamenti i Administrim Biznesit, Departamenti i Ekonomisë dhe Financës, Departamenti i Shkencave Humane dhe Shoqërore, si dhe Departamentit të Shkencave Kompjuterike), dy qendrave kërkimore (Qendra Kërkimore për Ekonomi dhe Biznes, si dhe Qendrën Kërkimore për Shkencat Sociale) dhe një instituti (Instituti i Studimeve për Demokraci dhe Zhvillim). Në vitin 2016-2017, UNYT-ja kishte 703 studentë të regjistruar në programet e studimit me kohë të plotë.

Përgatitja e Raportit të Vetëvlerësimit nga Grupi i Vetëvlerësimit të UNYT-së, që përbëhej prej shtatë anëtarësh, duke përfshirë drejtuesit e lartë, stafin akademik, personelin mbështetës dhe përfaqësuesit e studentëve, u nda në tri faza. Në fazën e parë, Grupi i Vetëvlerësimit u trajnua në kampus nga ekspertë të APAAL-it. Gjatë fazës së dytë u përcaktua metodologjia, u zhvilluan diskutime mbarë universitare për procesin nga organet drejtuese, u morën në intervistë studentët dhe anëtarët e personelit të universitetit, si dhe u mbledhën informacione të tjera. Në fazën e tretë, u hartua Raporti i Vetëvlerësimit, i cili iu vu në dispozicion të gjitha palëve të brendshme të interesit. Raporti i Vetëvlerësimit ishte i shkëlqyer. Gjuha e shkruar angleze ishte shumë e mirë dhe deklaratat ishin, në pjesën më të madhe, qartësisht të referuara. UNYT-ja ia ofroi Grupi i Vlerësimit të Jashtëm të gjitha dokumentet e kërkuara shtesë në kohën e duhur.

Vizita e vlerësimit u zhvillua gjatë dy ditëve, më 15 dhe 16 qershor 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të nivelit të lartë për arsimin e lartë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe nga një anëtar me përvojë në arsimin e lartë, pjesë e personelit të institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbështetej nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë përpara dhe gjatë vizitës. Në tërësi, u shqyrtuan 364 dokumente që i dhanë mundësi Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të njihej me strukturën, politikat, procedurat e drejtimit dhe natyrën e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të ndërmarrë nga UNYT-ja. Dokumentet përfshinin Statutin e UNYT-së, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listat e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumeve, shembujt e informimit rreth programit, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e lartë, studentët, pedagogët, personelin administrativ dhe mbështetës, si dhe partnerë të jashtëm, punëdhënës dhe alumni. Diskutimet ndihmuan në qartësimin e procedurave, përgjegjësiave dhe pikëpamjeve. Gjatë të gjitha takimeve, u mbajtën shënime si nga pjesëmarrësit nga Mbretëria e Bashkuar, ashtu edhe nga ata shqiptarë. Si pjesë e turit në kampus, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, ambientet e mësimdhënies, ambientet sociale dhe zyrat, si dhe pa një demonstrim të sistemeve online dhe elektronike të informacionit të UNYT-së.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë përmbushur kryesisht. Dy prej standardeve: **Standardi I.3 i Kapitullit III** dhe **Standardi III.1 i Kapitullit III**, nuk janë përmbushur plotësisht, por kjo gjë nuk përbën rrezik serioz për fushën e drejtimit. UNYT-ja punon në përputhje me

Statutin dhe rregulloret e tij, të cilat i përmirëson rregullisht. Ai menaxhohet me efikasitet nga organet drejtuese të tij si: Bordi i Aksionerëve, Senati dhe këshillat e fakultetit, ku personeli angazhohet në debat konstruktiv për lehtësimin e vendimmarrjes. Megjithatë, mungon transparenca në marrjen e vendimeve nga drejtuesit e nivelit më të lartë të UNYT-së, lidhur me veprimtaritë e Bordit të Aksionerëve, gjë që konsiderohet si dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon UNYT-së marrjen e masave të menjëhershme për publikimin e të gjitha procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të Aksionerëve. UNYT-ja ka hartuar një Strategji Zhvillimi për qëllimet e planifikimit, si dhe përpilon raportin e hollësishëm vjetor të monitorimit, të cilin ia vendos në dispozicion të gjithë personelit dhe studentëve, si dhe ia paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. UNYT-ja është e mirorganizuar dhe ka struktura të përshtatshme për përmbushjen e misionit të saj, që është ofrimi i arsimit cilësor për studentët e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë përmes katër departamenteve të dy fakulteteve. Gjithsesi, ai nuk ka një strategji për kërkimin e tregut, gjë që konsiderohet si dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon UNYT-së hartimin dhe zbatimin e një strategjie për kërkimin e tregut, në të ardhmen e afërt, ku do të bazohet hartimi i Planit Strategjik. UNYT-ja bashkëpunon me partnerët në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar, në dobi të personelit dhe të studentëve të tij. Gjithashtu, UNYT-ja punëson anëtarë stafi dhe pranon studentë të nivelit ndërkombëtar.

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht. Njëri prej standardeve, **Standardi IV.3 i Kapitullit III**, nuk është përmbushur, por kjo gjë nuk përbën rrezik serioz për fushën e drejtimit. UNYT-ja i menaxhon mirë burimet njerëzore. Ai e rekruton stafin në mënyrë transparente, përmes procedurave të qarta dhe politikës së punësimit të fakultetit. Në fillim të çdo viti, universiteti integron stafin akademik dhe kërkimor, si dhe personelin administrativ. Të gjithë i njohin mirë përgjegjësitë e tyre, në përputhje me udhëzimet specifike të universitetit. Stafi akademik vlerësohet çdo vit përmes planeve individuale të zhvillimit. Aktualisht, UNYT-ja nuk ka asnjë politikë promovimi, por është duke përditësuar rregullat e procedurave të brendshme të punës akademike, pjesë e të cilit do të jetë edhe një politikë e re promovimi. Mungesa e një politike promovuese konsiderohet si dobësi, pasi stafi nuk ka qasje në një politikë të shkruar për ecurinë e karrierës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon UNYT-së marrjen e masave të menjëhershme për hartimin dhe zbatimin e një strategjie të plotë për ngritjen në detyrë. UNYT-ja i menaxhon financat e saj me efikasitet, duke e hartuar buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligj dhe statutin e saj. Universiteti auditohet periodikisht së brendshmi dhe së jashtmi. Ai ka një sistem të mirë për menaxhimin e informacionit, përmes të cilit i menaxhon veprimet e tij në mënyrë efikase. Gjithashtu, universiteti i menaxhon mirë pasuritë e patundshme dhe ka arkivin e vet. UNYT-ja ka infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për ushtrimin e veprimtarive të tij. Ai zotëron dokumentacionin e plotë të veprimtarisë së tij akademike si në format të shtypur, ashtu dhe në format elektronik.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht. Njëri prej standardeve, **Standardi I.6 i Kapitullit I** nuk është përmbushur plotësisht, por kjo gjë nuk përbën rrezik serioz për fushën e drejtimit. UNYT-ja ofron programe studimi në përputhje me misionin, kapacitetet, dhe me Strategjinë e tij të Zhvillimit sipas prirjeve vendore, kombëtare (veçanërisht ligjore) dhe ndërkombëtare (veçanërisht ato të biznesit). Shumica e programeve janë qartësisht të përcaktuara dhe ofrohen në mënyrën e duhur brenda kapaciteteve të institucionit, si të burimeve njerëzore, ashtu edhe atyre fizike. Disa programe ofrojnë diploma të dyfishta. Programet e ciklit të parë iu ofrojnë studentëve njohuritë themelore. Ato janë hartuar për t'i ndihmuar studentët të përshtaten me institucionin dhe personelin e UNYT-së, proces ky që lehtësohet edhe nga vetë personeli. Njohja e një diplome amerikane Bachelor si një diplomë shqiptare në nivel Bachelor dhe Master Profesional konsiderohet si dobësi, pasi nuk bëhet qartësisht dallimi ndërmjet programeve të ciklit të parë dhe atij të dytë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon UNYT-së marrjen e masave të menjëhershme për riorganizimin e programeve të studimit si programe të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë dhe ofrimin e tyre veçmas. Programet e ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë mbështeten në punën aktive kërkimore të personelit dhe sugjerimet e partnerëve të bashkëpunimit. UNYT-ja ka të dhëna statistikore për të diplomuarit e tij. Ai përdor sistemin amerikan të krediteve për të gjitha programet, por i ka projektuar që të ekuivalentohen me standardet e Bolonjës, për t'i ofruar studentëve

mundësi për mobilitet në Evropë. Programet e studimit të UNYT-së ndërthurin punën teorike dhe praktike, gjë që i përgatit studentët për punësim.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht. Tre prej standardeve për kërkimin, përkatësisht **Standardi I.1**, **Standardi I.4** dhe **Standardi I.8 i Kapitullit II**, nuk janë përmbushur plotësisht, por kjo nuk përbën rrezik serioz për fushën e drejtimit. Të gjithë komponentët e programeve të studimit janë organizuar dhe zbatuar me efikasitet, duke përfshirë edhe ato të vendosjes në praktikë profesionale dhe stazhe, dhe studentët që i kanë përmbushur të gjitha kërkesat, pajisen me diplomë. Universiteti siguron përmirësimin e vazhdueshëm të të gjitha programeve të studimit përmes rishikimit dhe vlerësimit të semestrit nga studentët dhe personeli. Ai ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e mësimdhënies përmes programeve të vlerësimit të stafit dhe programeve të formimit, të cilat mbikëqyren nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve. Departamentet e UNYT-së nuk i mëshojnë pikave të tyre të forta dhe të dobëta në fushën e kërkimit shkencor, gjë që konsiderohet si dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon UNYT-së marrjen e masave të menjëhershme në mënyrë që të gjitha departamentet të nxjerrin në pah pikat e tyre forta dhe të dobëta në fushën e kërkimit shkencor, duke hartuar plane realiste për maksimizimin e pikave të forta dhe minimizimin e pikave të dobëta. UNYT-ja po përqendrohet në ndërkombëtarizimin e kërkimeve shkencore, megjithëse shumë prej mekanizmave për arritjen e këtij qëllimi janë ngritur vetëm kohët e fundit, dhe ende nuk kanë dhënë rezultate të qenësishme. UNYT-ja nuk i ka përcaktuar siç duhet fushat me përparësi në kërkimin shkencor, gjë që konsiderohet si dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon UNYT-së marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e një vizioni të qartë për zhvillimin e kërkimit shkencor në të ardhmen me objektiva specifike, të matshme, të realizueshme, të rëndësishme dhe me afate kohore të përcaktuara. UNYT-ja investon burime në ndërmarrjen e kërkimeve. Gjithashtu, ai e ka krijuar vijimësinë e kërkimit përmes Planit Strategjik të Zhvillimit 2012-2017, i cili do të merret parasysh për Planin Strategjik të Zhvillimit 2017-2022. UNYT-ja ka organizuar disa konferenca dhe i publikon rezultatet e kërkimit shkencor, por megjithëse regjistrohen, këto të fundit nuk vlerësohen, gjë që konsiderohet si dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon UNYT-së marrjen e masave të menjëhershme për hartimin dhe zbatimin e një politike për vlerësimin e rezultateve të kërkimit.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht. UNYT-ja ndjek politikën e përshtatshme për pranimin e studentëve të rinj dhe përdor portalin U-Shqipëri. Ai informon dhe komunikon me personelin dhe studentët e tij me efikasitet përmes takimeve ballë për ballë, emailit, medias sociale, njoftimeve të shtypura dhe faqes së tij të internetit. Dosjet e studentëve mbahen si në format të shtypur, ashtu edhe në format elektronik. Ai ka struktura të përshtatshme për mentorimin dhe udhëzimin e studentëve përgjatë programeve të tyre të studimit, siç janë shërbimet mbështetëse, këshilluesit akademikë dhe mbikëqyrësit individualë. Universiteti siguron literaturën bazë, si në format të shtypur, ashtu edhe në format elektronik, për nevojat e studentëve, ndërsa Manuali i plotë i Studentit konsiderohet si tipar i praktikës së mirë. UNYT-ja ofron mbështetje për studentët e kategorive të veçanta sociale, duke përfshirë ata me nevoja të veçanta, si p.sh me dëmtime në shikim. UNYT-ja i nxit studentët të marrin pjesë në jetën universitare nëpërmjet mbështetjes së Këshillit Studentor dhe përfaqësimit të studentëve në organet drejtuese. Ai siguron cilësinë kulturore dhe sportive të jetës së studentëve përmes veprimtarive të ndryshme dhe një fushe sportive në ambientet e brendshme. Ai i ndihmon studentët gjatë kalimit të tyre në punësim përmes Zyrës së posaçme të Karrierës dhe Alumni dhe marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit me institucionet vendore.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se standardet e cilësisë janë përmbushur plotësisht në një fushë dhe kryesisht në katër fusha.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Manuali i Studentëve i UNYT-së, i cili i siguron studentëve informacion lehtësisht të aksesueshëm dhe të hollësishëm në një dokument të vetëm rreth programeve të studimit dhe të gjitha aspekteve të tjera të jetës studentore në universitet (pika 5.3; **Kapitulli I Standardi III.3**).

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e transparencës në marrjen e vendimeve nga drejtuesit e nivelit më të lartë të UNYT-së (pika 1.6; **Kapitulli III Standardi I.3**)
- mungesa e një strategjie për kërkimin e tregut, ku do të bazohet hartimi i planit strategjik të UNYT-së (pika 1.12; **Kapitulli III Standardi III.1**)
- mungesa e një politike për ngritjen në detyrë (pika 2.3; **Kapitulli III Standardi IV.3**)
- njohja e një diplome amerikane Bachelor si një diplomë shqiptare e nivelit Bachelor dhe Master Profesional, pasi programet e studimit dhe objektivat e tyre nuk janë qartësisht të përcaktuara, dhe në këtë rast janë diferencuar në nivele të ndryshme (pika 3.7; **Kapitulli I Standardi I.6**)
- departamentet nuk nxjerrin në pah pikat e tyre të forta dhe të dobëta në fushën e kërkimit shkencor (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.1**)
- mungesa e një vizioni të qartë me prioritete specifike për zhvillimin e kërkimit shkencor në të ardhmen (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.4**)
- mungesa e vlerësimit të rezultateve të kërkimit shkencor të UNYT-së (pika 4.12; **Kapitulli II Standardi I.8**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- marrja e masave të menjëhershme nga UNYT-ja për publikimin e të gjitha procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të Aksionerëve (pika 1.6; **Kapitulli III Standardi I.3**)
- marrja e masave në të ardhmen e afërt nga UNYT-ja për hartimin dhe zbatimin e një strategjie për kërkimin e tregut, ku do të bazohet hartimi i planit të tij strategjik (pika 1.12; **Kapitulli III Standardi III.1**)
- marrjen e masave të menjëhershme nga UNYT-ja për hartimin dhe zbatimin e një politike të plotë për ngritjen në detyrë (pika 2.3; **Kapitulli III Standardi IV.3**)
- marrja e masave të menjëhershme nga UNYT-ja, për riorganizimin e diplomës amerikane Bachelor dhe programeve shqiptare të studimit në nivelin Bachelor dhe Master Profesional, si programe të ciklit të parë dhe të dytë, dhe ofrimi i tyre veçmas (pika 3.7; **Kapitulli I Standardi I.6**)
- marrja e masave të menjëhershme nga UNYT-ja në mënyrë që të gjitha departamentet të nxjerrin në pah pikat e tyre të forta dhe të dobëta në fushën e kërkimit shkencor, duke hartuar plane realiste për maksimizimin e pikave të forta dhe minimizimin e pikave të dobëta (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.1**)
- marrja e menjëhershme e masave nga UNYT-ja, për krijimin e një vizioni të qartë për zhvillimin e kërkimit shkencor në të ardhmen me objektiva specifike, të matshme, të realizueshme, të rëndësishme dhe me afate kohore të përcaktuara (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.4**)

- marrjen e menjëhershme të masave nga UNYT-ja për hartimin dhe zbatimin e një politike për vlerësimin e rezultateve të kërkimit (pika 4.12; **Kapitulli II Standardi I.8**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

Përmbledhje e gjykimeve për çdo fushë vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur kryesisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**.

Gjykim i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit se në Universitetin “New York” të Tiranës standardet shtetërore të cilësisë janë **përbushur kryesisht**.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 UNYT-ja është një institucion jopublik i arsimit të lartë, që gëzon autonomi dhe liri akademike. Ai është themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 397, datë 15 gusht 2002. Veprimtaria e UNYT-së mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 9741, datë 12 maj 2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. **[2, Krijimi, fq. 2]** UNYT-ja ka ofruar programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, siç përcaktohet në aktet ligjore, që prej miratimit të statusit të UNYT-së si universitet, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 11 korrik të vitit 2012. Programet e doktoratës në Administrim Biznesi, Shkenca Kompjuterike, si dhe Shkenca Humane dhe Shkenca Shoqërore janë akredituar me Urdhrin e Bordit të Akreditimit nr. 3, më 07 Prill të vitit 2017. **[2]** Krahas Masterit të Shkencave në Drejtësi, i cili është i vlefshëm edhe nga Universiteti i Greenwich-it, MB, të gjitha programet ofrohen në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të "New York Empire State College". **[RVV fq. 4; 28.]** Strukturat e UNYT-së veprojnë sipas statutit të tij. **[2; 2.1; 2.2]** Unioni Studentor ka hartuar kushtetutën e vet, e cila është aktualisht nën rishikim. **[19.2.1; RVV fq.5] [Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.2 Bordi i Aksionerëve është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton misionin e Universitetit, duke përfshirë proceset e tij financiare dhe administrative. **[02, nenet 8 dhe 9]** Bordi i Aksionerëve vepron në pajtim me nenin 81 të Statutit dhe ligjin nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë" me funksione të përcaktuara në aktin e themelimit të UNYT-së si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, më 26 prill të vitit 2002. **[1; B1.1.2, Nenet 8 dhe 10]** Statuti i Universitetit përcakton funksionet institucionale të Bordit të Aksionerëve. **[2, neni 31; B1; B1.1.1]** Organet e tjera vendimmarrëse kolegjinale janë Senati, Rektorati dhe struktura të tjera, që veprojnë në përputhje me Statutin. **[RVV fq.6; 2, nenet 7 - 49; B1.1.2]** Rektori dhe administratori i UNYT-së janë autoritetet më të larta akademike dhe administrative, të cilët punojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin. **[2, nenet 19 dhe 21]** Deri me hyrjen në fuqi të ligjit të ardhshëm për arsimin e lartë në Shqipëri (Ligji 80/2015), UNYT-ja do të vazhdojë të drejtohet nga Bordi i Aksionerëve, sipas akteve nënligjore të kompanisë, pas këshillimit me Rektoratit, Njësinë e Sigurimit të Cilësisë dhe Zyrën e Financës. **[2, Nenet 8 dhe 9] [Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.3 UNYT-ja është aktualisht në procesin e krijimit të strukturave të reja vendimmarrëse, ku Bordi i Administrimit do të ketë përgjegjësi operacionale, ndërsa Bordi i Aksionerëve do të ketë fuqinë vendimmarrëse për çështjet kyçe strategjike. Kjo marrëveshje u miratua nga Bordi i Aksionerëve dhe Senati Akademik në mars të vitit 2017 dhe iu dorëzua Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për miratim përfundimtar më 23 mars të vitit 2017. **[2.2]** Aktualisht Bordi i Aksionerëve drejtohet nga Menaxheri i Përgjithshëm, dhe procesverbalet e mbledhjeve konsiderohen si konfidenciale dhe/ose delikate. Krahas vendimeve që prekin disa çështje akademike, procesverbalet nuk publikohen. **[M1; M4; M14] [Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.4 Vendimet e Senatit janë plotësisht transparente dhe zbatohen nga Rektorati. **[M4; M5]** Veprimet në nivel fakulteti dhe departamenti menaxhohen nga këshillat e tyre përkatës. Çështjet etike i delegohen Këshillit të Etikës, **[2, neni 15]**, ndërsa monitorimi i cilësisë dhe standardeve është përgjegjësi e Këshillit të Sigurimit të Cilësisë. **[2, neni 16]** Çështjet që lidhen me studentët zgjidhen nga Këshilli Akademik, **[2, neni 17]**, ndërsa shkolla e doktoratës drejtohet nga Këshilli i Profesorëve. Grupi i vlerësimit nuk mundi ta konfirmonte drejtimin e ciklit të tretë të studimeve nga Këshilli i Profesorëve. **[2, neni 14; C19.1; M12]** Çështjet e fakultetit diskutohen në Asamblenë e Fakultetit. **[2, neni 13]** Studentët kontribuojnë përmes përfaqësuesve të tyre në të gjitha organet e larta

vendimmarrëse kolegjiale. **[RVV fq.7; 19.3; 19.1; Sqarime 2; B1.2.1; Mbledhje; B1.2.2]**
[Kapitulli III Standardi I.2]

- 1.5 UNYT-ja nxit debatin konstruktiv, siç dëshmohej nga diskutimet për buxhetin në Senat dhe Rektorat, si dhe nga administratorët e UNYT-së dhe Bordit të Aksionerëve. Axhenda e mbledhjeve, së bashku me materialet përkatëse iu shpërndahet të gjitha niveleve paraprakisht. **[3.1; 19.8; 24; 26.1]** Senati mbledhet të paktën dy herë gjatë vitit akademik, në varësi të çështjeve që duhen zgjidhur. **[2, Nenet 11-12]** Rektorati monitoron zbatimin e veprimeve të miratuara nga Senati, dhe i raporton periodikisht Senatit dhe Bordit të Aksionerëve. **[2, neni 19]** Rektori, si Kryetari i Senatit, përfaqëson komunitetin akademik. Vendimet që merr Senati komunikohen me anë të bisedave, kopjeve në format të shtypur dhe emailit. **[M2]** Staf i akademik kontribuon dhe informohet rreth procesit vendimmarrës në mënyrë joformale përmes Përgjegjësit të Departamentit, dhe në mënyrë formale me email nga Sekretari i Rektorit. Gjithashtu, ata japin kontributin tyre në raportet vjetore. **[M13]** Një kopje e procesverbaleve të mbledhjeve të departamenteve mbahet nga sekretarja e Rektorit për t'u arkivuar, ndërsa tjetra ruhet në arkivin e departamentit. Rezultatet i bëhen me dije stafit, si dhe përfaqësuesit të studentëve. **[M11]** **[Kapitulli III Standardi I.3]**
- 1.6 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua se Këshilli Administrativ nuk është emëruar ende dhe se as ligji i ri nuk është miratuar. Rrjedhimisht, vendimet strategjike vazhdojnë të merren nga Bordi i Aksionerëve, dhe shpërndahen vetëm procesverbalet e mbledhjeve të këtij të fundit, që ndikojnë në çështjet akademike. **[M14]** Për shembull, vendimet përfundimtare në lidhje me shpërndarjen e burimeve merren vetëm nga Bordi i Aksionerëve, por procesverbali i këtyre vendimeve strategjike nuk qarkullohet. **[M1; M11]** Grupi i Vlerësimit vëren **[RVV fq.7]** se Bordi i Aksionerëve duhet të bëjë një regjistrim më sistematik dhe transparent të procesverbaleve të mbledhjeve, pas miratimit të statutit të ri. **[2.2]** Megjithatë, mungesa e transparencës në marrjen e vendimeve të drejtuesve të nivelit më të lartë të UNYT-së konsiderohet si **dobësi**, pasi nënkupton se vendimet e kompanisë që mund të prekin drejtpërdrejtë të gjithë personelin e UNYT-së nuk qarkullohen. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** marrjen e menjëhershme të masave nga UNYT-ja për publikimin e të gjitha procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të Aksionerëve. **[Kapitulli III Standardi I.3]**
- 1.7 Në UNYT funksionojnë një sërë strukturash mbikëqyrëse. **[RVV f.7]** Për shembull, Zyra e Financës mbikëqyret nga Senati, **[2, neni 35]** audituesit e brendshëm **[12 Raporti i auditit të brendshëm]** dhe ato të jashtëm. **[13]** Personeli ka aplikuar për fonde të jashtme evropiane, **[3.2; 3.3]** por UNYT-ja shpreson të konkurrojë në mënyrë më efektive për financimin evropian, si rrjedhojë e vendimit të Senatit për krijimin e një Zyre për Kërkimin dhe Zhvillimin **[24]** dhe vendimin e Bordit të Aksionerëve për themelimin e Fondacionit UNYT. **[30]** **[Kapitulli III Standardi I.4]**
- 1.8 Plani Strategjik i Zhvillimit i UNYT-së për periudhën 2013-2017 u miratua në vitin 2012, **[3]** dhe Strategjia e Kërkimit për periudhën 2014-17 u hartua në vitin 2014 **[9]** në përputhje me misionin, qëllimet dhe vlerat e institucionit. **[RVV fq.8]** Aktualisht, Plani strategjik pesëvjeçar i UNYT-së është në proces rishikimi, pas vendimit të Senatit më 23 mars të vitit 2017 për emërimin e një komisioni rishikimi. **[3.1, çështja 5, pika 4]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua se komisioni i rishikimit do të udhëhiqet nga një drejtues për kërkimin dhe një drejtues akademik. **[M2; M4; M5]** Fillimisht, ai do të krijojë një vizion të ri për UNYT-në, duke përfshirë nevojën për një kampus dhe fakultet të ri, përkatësisht Fakultetin e Informatikës, për trajtimin e nevojave të tregut vendor. **[M1]** Strategjia e re pesëvjeçare 2018-2023 do të përbëhet nga një strategji e re institucionale kërkimore, që do të përfshijë aspiratat dhe rezultatet kërkimore të fakultetit të ri. **[M3]** Ai do të përqendrohet më së shumti në ofrimin e ciklit të dytë sipas modelit amerikan. **[T2]** **[Kapitulli III Standardi I.5]**

- 1.9 Raporti vjetor i UNYT-së është pika kulmore e procesit vjetor të vetëvlerësimit, në përgatitjen e të cilit angazhohen zyrat e financës, sekretarisë mësimore, marketingut dhe marrëdhënies me publikun; fakultetet, departamentet, Këshilli i Profesorëve dhe shërbimet mbështetëse të studentëve. **[RVV fq. 8; 3.2; 3.3]**. Raporti vjetor shpërndahet dhe diskutohet në shkallë të gjerë, dhe më pas miratohet në Senat. Raporti përfundimtar i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, stafit akademik dhe studentëve. Gjithashtu, raporti vjetor përcakton objektivat vjetore dhe vendimmarrjen në vitet pasardhëse, si p.sh rritjen e cilësisë së studentëve të rinj të pranuar **[3.3]** dhe problemet lidhur me stafin e departamenteve. **[28.1]** Komisioni i Sigurimit të Cilësisë merret me sigurimin e cilësisë dhe me mbështetjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me stafin akademik dhe personelin administrativ. **[8, f. 8-10]** Universiteti i ngarkon departamentet akademike me detyrën e mbikëqyrjes, monitorimit dhe përmirësimit të programeve të tyre akademike në raportet vjetore të monitorimit, që përfshijnë reagimet ndaj planeve të veprimit nga raporti i vitit të mëparshëm dhe përmbajnë një vështrim të përgjithshëm reflektues si dhe pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe analizën e rreziqeve. **[28; 28.1]** Raporti vjetor i universitetit ndjek ecurinë drejt përmbushjes së qëllimeve strategjike të Planit Strategjik 2012-2017 dhe përfshin një plan veprimi për objektivat e reja në vitin e ardhshëm. **[B4.1] [Kapitulli III Standardi I.5; Kapitulli III Standardi I.6]**
- 1.10 Misioni i UNYT-së është të përgatisë profesionistë të ardhshëm, përmes mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit, duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe integritet në komunitet. **[2, Neni 1]** Ai realizohet në dy fakultete, ku secili ka dy departamente dhe një qendër kërkimore. **[1]** Fakulteti i tretë, ai i Informatikës, do të hapet në fund të vitit 2017. Vendimi për themelimin e këtij fakulteti të ri u miratua nga Bordi i Aksionerëve dhe me Vendimin e Senatit Akademik nr. 28, më 26 shtator të vitit 2016. **[B2.1.2; B2.1.3; B2.1.4]** Njësitë administrative lehtësojnë gjithashtu përmbushjen e misionit dhe ushtrimin e plotë të autonomisë, brenda ligjit. **[M14]** Liria akademike në mësimdhënie, mësimnxënie dhe kërkim garantohet me Statut dhe monitorohet nga Senati, Këshilli i Etikës, fakultetet dhe departamentet akademike. **[02, Neni 2]** UNYT-ja ka faqen e saj zyrtare të internetit, që aktualisht është duke u përditësuar www.unyt.edu.al. **[Kapitulli III Standardi II.1]**
- 1.11 UNYT-ja lehtëson marrjen e vendimeve, duke nxitur debatin në organet e tij drejtuese, ku përfshihen Këshilli Akademik, Senati Akademik dhe mbledhjet e departamenteve. Një shembull i mirë është komunikimi dhe debati për caktimin e buxheteve brenda departamenteve akademike, që fillon më 6 maj të vitit 2016, **[11.3]** më pas diskutimi në Senatin Akademik më 26 shtator të vitit 2016, **[11.4, Tema 6]** dhe në fund vendimi i miratimit nga Senati Akademik më 5 dhjetor të vitit 2016. **[11.5]** Kjo transparencë u mbështet dhe u respektua gjatë mbledhjeve të vizitës së vlerësimit. **[M1; M2; M4; M5; M11; M13]** Gjithashtu, studentët marrin pjesë në organet e larta vendimmarrëse kolegjiale. **[B1.2.1; B1.2.2; B1.2.3; B1.2.4]** Megjithatë, UNYT-ja pranon se duhet të zhvillojë një program formimi për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre efikase në mbledhje. **[Sqarimet 2] [Kapitulli III Standardi II.3]**
- 1.12 UNYT-ja monitoron zhvillimet socio-ekonomike rajonale për marrjen e informacioneve rreth operacioneve të tij dhe për realizimin e planit të tij strategjik. **[RVV f.10; 35]** Burime të rëndësishme informacioni janë universitetet partnere, Dhomat e Tregtisë dhe Shoqata e Investitorëve të Huaj. Zyra e Karrierës dhe e Alumni ka 26 kontakte me komunitetin e biznesit dhe mban një bazë të dhënash vjetore për të diplomuarit e çdo cikli studimi. Sipas pyetësorit, nga 436 të diplomuarit e ciklit të parë për periudhën 2012-2016, 56 përqind ishin të punësuar, paçka se 34 përqind nuk morën pjesë. Nga 279 të diplomuarit të ciklit të dytë për të njëjtën periudhë, 57 përqind ishin të punësuar, megjithëse 39 përqind nuk morën pjesë. Nëse përgjigjet “jo” përjashtohen nga këto llogaritje, shkalla mesatare e punësimit për periudhën 2012-2016 e të diplomuarve të ciklit të parë është 86 përqind, ndërsa e të diplomuarve të ciklit të dytë për të njëjtën periudhë është 94.5 përqind. **[68; Sqarime 6; B1.6]** Të dhënat për punësimin e të diplomuarve të ciklit të

tretë nuk janë ende të disponueshme. Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët dhe anketimet përfshihen në raportet vjetore. **[B4.1]** Rishikimi sistematik dhe kërkimi i tregut mbeten objektiva të vazhdueshme, në mënyrë që të sigurohet mbështetja e vendimeve dhe operacioneve të UNYT-së në fakte. **[Sqarimet 7]** Kohët e fundit, UNYT-ja ka marrë pjesë në një mbledhje të quajtur "Nga arsimit në punësim: çfarë ofrojnë universitetet dhe çfarë presin tregjet e punës". **[B1.7.1]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk mundi të gjejë asnjë provë të ekzistencës së një strategjie për kërkimin e tregut. **[M3; M4; M5; M14]** Mungesa e një strategjie për kërkimin e tregut, ku do të bazohet hartimi i Planit Strategjik të UNYT-së konsiderohet si **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon UNYT-së marrjen e masave në të ardhmen e afërt për hartimin dhe zbatimin e një strategjie për kërkimin e tregut, ku do të bazohet hartimi i Planit të tij Strategjik. **[Kapitulli III, Standardi III.1]**

- 1.13 UNYT është një universitet me orientim ndërkombëtar. Ai bashkëpunon me Universitetin Shtetëror të "New York Empire State College", Universitetin e Greenwich-it dhe Universitetin e Boltonit, gjë e cila i jep mundësinë studentëve të marrin diplomë nga këto institucione. **[RVV fq.10; 02, Neni 6; M8]** Gjithashtu, si pjesë e Grupit Arsimor të Kolegjit "New York Jork", UNYT-ja bashkëpunon me Kolegjin "New York" në Athinë, Selanik dhe Pragë. UNYT-ja ndjek një strategji ndërkombëtarizimi në lidhje me trupën studentore **[3, Qëllimi Strategjik 4.1]** dhe fakultetet **[03, Qëllimi Strategjik 4.2]** përmes një rrjeti partneritetesh ndërkombëtare **[3, Qëllimi Strategjik 6]** dhe programeve të shkëmbimit të studentëve, personelit dhe kërkuesve. **[3, Qëllimi Strategjik 4.3]** UNYT-ja ka krijuar partneritete si në rang kombëtar, ashtu edhe në rang rajonal. Në listën e marrëveshjeve të mëparshme dhe aktuale, dhe të memorandumëve të bashkëpunimit renditen 26 partneritete, prej të cilave nëntë janë në rang kombëtar, gjashtë në rang rajonal dhe 11 në rang ndërkombëtar. **[10.1; 35.1] [Kapitulli III Standardi III.2]**
- 1.14 Zyra e Karrierës dhe Alumnit, si dhe drejtuesit e UNYT-së mbajnë lidhje të ngushta me Departamentin e Administratës Publike, si dhe me organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, në dobi të të diplomuarve të UNYT-së, veçanërisht për kryerjen e stazheve. Nga 26 memorandumet e bashkëpunimit, 22 lidhen me programet e stazhit në Shqipëri, duke përfshirë ministri, organizata publike dhe jopublike. Alumni, partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit janë shprehur tejet të kënaqur me praktikantët, dhe në disa raste, i kishin përzgjedhur të diplomuarit e UNYT-së për punësim. **[T8]** Edhe studentët e ciklit të dytë dhe të tretë i konfirmuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se praktikantët ishin ndjekur më pas nga punësimi. **[M7]** Shihni edhe pikën 3.13 më poshtë. **[RVV faqe 11; 35; 35.2] [Kapitulli III Standardi III.3]**
- 1.15 Zyra për Marrëdhëniet me Jashtë u krijua në vitin 2016 për lehtësimin e shkëmbimeve të personelit dhe studentëve, e cila ka si gjuhë zyrtare komunikimi gjuhën angleze. **[RVV faqe 11; 10]** Objektivat fillestare ishin shumë modeste. Aktualisht, në shkëmbime janë përfshirë tre studentë, dy anëtarë të fakultetit dhe një anëtar i personelit administrativ. **[Sqarimet 9; B1.9]** Aktualisht, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë është duke promovuar shkëmbimet në Republikën Çeke, Francë dhe Turqi. Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të veprojnë si profesorë vizitorë dhe do të marrin pjesë në programet e doktoratës. **[Kapitulli III Standardi III.4]**
- 1.16 UNYT-ja mbështet financiarisht shkëmbimet e personelit duke mbuluar lejen e paguar, si dhe shpenzimet e udhëtimit dhe të konferencës. **[RVV f. 12; 09]** Për të ndihmuar qëndrimin dhe integrimin në Shqipëri, stafit ndërkombëtar iu ofrohet një manual gjithëpërfshirës, **[14]** si dhe mirëpritjen dhe mbështetjen nga departamentet akademike në mënyrë të përshtatshme. **[T13]** Zyrat e Pranimeve, Marketingut dhe Marrëdhënieve me Publikun ndjekin në mënyrë aktive mobilitetin e studentëve ndërkombëtare, veçanërisht brenda rajonit. **[36]** Unioni Studentor dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë i ndihmojnë studentët në integrimin e tyre në Tiranë. **[19.6]** Unioni dhe Këshilli Studentor nxisin në mënyrë aktive shkëmbimet e studentëve dhe mobilitetin ndërkombëtar. **[T3; T7] [Kapitulli III Standardi III.4]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e transparencës në marrjen e vendimeve nga drejtuesit e nivelit më të lartë të UNYT-së (pika 1.6; **Kapitulli III Standardi I.3**)
- mungesa e një strategjie për kërkimin e tregut, ku do të bazohet hartimi i Planit Strategjik të UNYT-së (pika 1.12; **Kapitulli III Standardi III.1**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- marrja e menjëhershme të masave nga UNYT-ja për publikimin e të gjitha procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit së Aksionerëve (pika 1.6; **Kapitulli III Standardi I.3**)
- marrja e masave nga UNYT-ja në të ardhmen e afërt për hartimin dhe zbatimin e një strategjie për kërkimin e tregut, ku do të bazohet zhvillimi i Planit të tij Strategjik (pika 1.12; **Kapitulli III Standardi III.1**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 UNYT-ja ka një dokument politike të detajuar për përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të stafit akademik, me procedura dhe shembuj të përshtatshëm, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Shqipëri. Stafi akademik dhe personeli administrativ përzgjidhet në bazë të meritave, ku përparësi i jepet stafit akademik nga universitetet e njohura më rang ndërkombëtar. **[RVV f. 12; 7.3; 7.2; 7.2.1]** Studentët marrin pjesë në leksionet e lektorëve të ftuar, duke dhënë feedback-un e tyre për ta. Organigrama është publikuar sipas Statutit. **[4; 4.1] [Kapitulli III Standardi IV.1]**
- 2.2 UNYT-ja përpiqet të krijojë një kulturë dhe mjedis gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues përmes veprimtarive akademike, shkencore, administrative dhe sociale. **[26.2 Përgatitja dhe axhenda për mbledhjen e ciklit të parë; 43 Dokumente nga veprimtaritë sociale]** Integrimi i stafit të sapoemëruar dhe programi gjithëpërfshirës i orientimit në fakultet përshkruhen plotësisht në udhëzuesin e detajuar. **[14; 14.1; 14.3]** Studiuesit e prezantojnë punën e tyre përmes seminareve dhe e ftojnë stafin dhe studentët të japin feedback-un e tyre. **[RVV f.44; 44] [Kapitulli III Standardi IV.2]**
- 2.3 Të gjithë anëtarët e stafit të fakultetit hartojnë një plan zhvillimi individual, si pjesë të objektivave të tyre vjetore, i cili vlerësohet në fund të vitit akademik. **[33; 28.3]** UNYT-ja nxit përvojën ndërkombëtare të stafit përmes shkëmbimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca. Pavarësisht se kriteret për instruktorët, lektorët, asistent profesorët, profesorët e asociuar dhe profesorët me kohë të plotë ishin të përcaktuara qartë, **[15]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk gjeti asnjë provë për procesin e ngritjes në detyrë. Më 27 mars të vitit 2017, u zhvillua një takim me dy anëtarë të Grupit të Vetëvlerësimit dhe menaxherin e burimeve njerëzore, ku u diskutua rreth politikës së ngritjes në detyrë të UNYT-së dhe zbatimit të saj. Ata u shprehën se nuk kishte asnjë politikë të plotë dhe se kishte filluar të ndërmerrej procesi i përditësimit dhe përmirësimit të Rregullave të Procedurës së Brendshme Akademike të vitit 2008, e cila parashikonte politika dhe dispozita për ngritjen në detyrë të stafit. **[20.1; 20.2; 07]** Mungesa e një politike për ngritjen në detyrë konsiderohet si **dobësi**, pasi stafi nuk ka akses në asnjë politikë të shkruar për ecurinë e karrierës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i **rekomandon** UNYT-së marrjen e menjëhershme të masave për hartimin dhe zbatimin e një politike të plotë për ngritjen në detyrë. Gjithashtu, personeli administrativ nxitet të marrë pjesë në zhvillimin personal, nëpërmjet ndjekjeve të kurseve ose programeve të studimit me tarifa të reduktuara. **[M14]** Në gusht të vitit 2017, është planifikuar formalizimi i politikës së vlerësimit periodik të personelit administrativ. **[15.1; 27] [Kapitulli III Standardi IV.3]**
- 2.4 UNYT-ja ndjek një politikë për zhvillimin social, duke zgjeruar disa prej shërbimeve të fakultetit, personelit administrativ dhe studentëve në komunitetin më të gjerë shoqëror. Për shembull, ai rrit ndërgjegjësimin për trashëgiminë kulturore kombëtare. Një shtyllë e përditësuar e kërkimit është menaxhimi i trashëgimisë kulturore, e përqendruar në Muzeun Onufri, që strehon disa nga thesaret më të rëndësishme kulturore në Shqipëri. Një prej objektivave është zhvillimi i modulit pedagogjik ndërdisiplinor pilot për studentët, të mbështetur në ekspozita. **[9.1, Projekti 2.1, fq. 12-14]** Gjithashtu, Unioni Studentor organizon një klub bamirësie. **[46]** UNYT-ja paguan sigurimin shëndetësor të personelit, duke e mbajtur nga paga bruto e stafit dhe duke paguar kontributet, sipas legjislacionit vendas. Gjithashtu, ai e ndihmon stafin në gjetjen e skemave private të sigurimit shëndetësor. **[15, Seksioni B5] [Kapitulli III Standardi IV.4]**
- 2.5 Aktualisht, UNYT-ja është duke shqyrtuar një dokument i cili përcakton tonin dhe pritshmëritë e të drejtave dhe detyrave të stafit akademik, në përputhje me Statutin e tij. **[RVV f. 14; 02, nenet 55 -59; 7; 7.1]** Vlerësimi erdhi si rezultat i punës përgatitore për vlerësimin institucional. Puna fillestare tregoi se, paçka se burimet njerëzore menaxhohen në mënyrë efikase, me përjashtim të ngritjes në detyrë të stafit akademik (shihni pikën 2.3 më sipër), UNYT-ja duhet t'i përditësojë aspektet e tjera të menaxhimit të burimeve njerëzore, ku përfshihen politika e punësimit për personelin administrativ

dhe udhëzuesin për stafin ndërkombëtar. **[20.1]** Puna fillestare përfshiu edhe një plan veprimi me gjashtë pika për rishikimin e procedurave e brendshme të punës. **[20.2]** **[Kapitulli III Standardi II.2]**

- 2.6 UNYT-ja e harton buxhetin e tij në përputhje me procedurat e përcaktuara. **[11.2]** Edhe Zyra e Financës vepron sipas Kodit të Praktikës. **[11]** Procesi fillon në prill ose maj, kur të gjitha njësitë dhe departamentet organizative plotësojnë një formular elektronik. Këtu përfshihen kërkesat për financim për personelin, kompjuterat, IT-në, kërkimin dhe zhvillimin. Secili element mbështet prioritetet e Planit Strategjik. Përgjegjësi i financës e përgatit projektbuxhetin për shqyrtim nga Bordi i Aksionerëve, i cili më pas i dorëzohet Senatit për diskutim dhe miratim. **[11.2; 11.5]** Rektorati, Bordi i Aksionerëve dhe Zyra e Financës zgjidhin çdo mosmarrëveshje. **[RVV fq.15; 11.4]** **[Kapitulli III Standardi VI.1]**
- 2.7 Politika financiare e UNYT-së zbatohet nga Zyra e Financës. Informacioni i mbledhur është përdorur në mënyrë strategjike për mbështetjen e zhvillimit dhe kostos së programeve. Krahas sigurimit të stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së institucionit, Zyra e Financës i ndjek praktikat e kontabilitetit, në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit, përgatit pasqyrat financiare brenda afatit, monitoron buxhetet, përgatit parashikimet e qarkullimit të parasë, parashikon të ardhurat në fund të vitit, verifikon gjendjen e llogarisë çdo muaj dhe monitoron saktësinë e informacionit. Praktikrat e kontabilitetit janë në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit. **[RVV fq.15; 11.2; 12; 13]** Pasqyrat financiare përgatiten për Bordin e Aksionerëve, Administratorin e Universitetit dhe drejtuesit. Buxhetet monitorohen çdo muaj, krahasuar me parashikimin e qarkullimit të parasë dhe të ardhurave në fund të vitit. Ky proces rishikohet së brendshmi për sigurimin e informacionit të saktë financiar. UNYT-ja ndjek një politikë transparence për shpërndarjen e burimeve financiare nga Senati Akademik e më poshtë, por veprimet e Bordit të Aksionerëve nuk janë transparente (shihni pikën 1.6 më sipër). **[Kapitulli III Standardi VI.2]**
- 2.8 Siç u përmend në pikën e mësipërme, Zyra e Financës i nënshtrohet çdo vit auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Audituesit e brendshëm emërohen nga Bordi i Aksionerëve, ndërsa për auditimin e jashtëm, UNYT-ja emëron një kompani të pavarur në Tiranë. **[13]** Raporti i auditit të brendshëm synon të ofrojë siguri të arsyeshme në lidhje me efektshmërinë dhe efikasitetin e operacioneve, besueshmërinë e raportimit financiar dhe të menaxhimit, dhe pajtueshmërinë me politikrat dhe rregulloret. Plani vjetor i auditit është zhvilluar mbi rëndësinë dhe rrezikun, bazuar në rishikimin financiar, shqyrtimin e pajtueshmërisë, rishikimin operacional dhe rishikimin e sistemeve për menaxhimin e informacionit. **[12]** Procesi i rishikimit të sistemeve të menaxhimit të informacionit shqyrton kontrollin, mbështetjen, planet e rimëkëmbjes dhe sigurinë e sistemit. Auditimi vjetor i jashtëm përbëhet nga një shqyrtim mujor i dokumentacionit kontabël dhe fiskal për identifikimin e efekteve tatimore dhe për verifikimin e përputhshmërisë së transaksionet të kryera nga Zyra e Financës me ligjet fiskale dhe legjislacionin e kontabilitetit në Shqipëri. **[13]** Të dyja auditimet sigurojnë përgjegjësinë në shpenzimin e fondeve, duke përfshirë kërkimet që mbështeten me grante të jashtme. **[13.1]** **[Kapitulli III Standardi VI.3]**
- 2.9 UNYT-ja ka një sistem informacioni të integruar i cili përdoret gjithashtu nga institucionet e tij simotra në Pragë dhe Athinë. Ai iu siguron studentëve qasje në një sërë informacionesh të lidhura me programet e tyre të studimit. Ky informacion iu vihet në dispozicion edhe departamenteve dhe Rektoratit për nevojat e raportimit dhe vendimmarrjes. Zyra e Financës përdor softuer të specializuar për regjistrimet dhe nevojat e raportimit. Faqja e internetit e UNYT-së përdoret gjithashtu si një sistem informacioni publik. **[RVV fq.16]** Zyra e mbështetjes së IT-së vepron sipas rregullave dhe rregulloreve, që aktualisht janë në proces vlerësimi, dhe harton një manual gjithëpërfshirës për sigurinë e IT-së. **[47; 47.2]** **[Kapitulli III Standardi VII.1]**

- 2.10 Të gjitha veprimtaritë e UNYT-së janë plotësisht të kompjuterizuara. Universiteti ka tetë laboratorë informatike për mësimdhënie, mësimnxënie dhe kërkime. **[RVV fq.17; M10]** i gjithë informacioni lidhur me studentët (shihni pikën 2.20 më poshtë) ruhet në bazën e të dhënave dixhitale, në Sistemet Gnomom të Bazës së të Dhënave. Këto të dhëna iu vihen në dispozicion departamenteve, fakulteteve dhe Rektoratit për nevojat e raportimit dhe si dokumente për vendimmarrje. Zyra e Financës përdor edhe një softuer të specializuar për të dhënat e saj, të quajtur ALPHA Business, ku ruhet rregullisht informacioni i të gjithë kompjuterave. **[47]** Zyra e IT-së mban gjithashtu Manualin e Sigurisë së Informacionit dhe Dokumentet e Punës së Zyrës së IT-së, **[47.1]** të cilat rendisin shërbimet, politikat dhe marrëveshjet. **[47.2] [Kapitulli III Standardi VII.2]**
- 2.11 UNYT-ja mban një regjistër të aseteve afatgjata dhe pronave të paluajtshme, i cili është i certifikuar nga auditit i jashtëm. **[13.2]** Asetet afatgjata menaxhohen sipas Kodit të Praktikës të Zyrës së Financës. **[11]** Është planifikuar edhe një kampus i ri modern, por ndërtimi i tij është shtyrë për “arsye objektive”. **[RVV fq.17; 13.3]** Vendimi për kampusin e ri modern u mor nga Bordi i Aksionerëve më 14 korrik 2006. Aktualisht, po merren lejet zyrtare nga të gjitha autoritetet e qeverisë kombëtare. **[B2.1 dhe B2.1; B2.1.1] [Kapitulli III Standardi VII.3]**
- 2.12 UNYT-ja ruan, mirëmban dhe zhvillon trashëgiminë akademike, kulturore dhe shkencore. I gjithë stafi është i pajisur me kompjutera që mirëmbahen rregullisht. Biblioteka është arkivi i të gjitha botimeve të stafit dhe të UNYT-së, duke përfshirë temat e masterit dhe doktoratës, që ruhen në format të shtypur dhe elektronik. **[RVV fq.17; <http://unyt.edu.al/facilities-3/>; M10] [Kapitulli III Standardi VII.4]**
- 2.13 UNYT-ja ka infrastrukturë të përshtatshme për ndjekjen e veprimtarive të tij të mësimdhënies dhe për ofrimin e hapësirës së punës për stafin akademik dhe kërkimor, si dhe personelin ndihmës dhe administrativ. **[01; M10]** Zyra e Menaxhimit të Operacioneve ka një masterplan të të gjitha mjediseve të UNYT-së për përdorimin sa më të mirë të mundshëm të ndërtesës. Të gjitha veprimet drejtohen nga politikat dhe procedurat e Zyrës së Menaxhimit të Operacioneve. **[RVV fq.17; 48; 49] [Kapitulli III Standardi VII.5]**
- 2.14 Zyra e Menaxhimit të Operacioneve të UNYT-së koordinon dhe menaxhon logjistikën e strukturave administrative, me qëllim kryerjen e veprimeve me interes institucional. **[01, Seksioni C]** Ajo përdor rezultatet e anketimeve për të vlerësuar efikasitetin e saj dhe atë të të gjitha shërbimeve logjistike të UNYT-së, duke përfshirë anketimin për feedback-un e studentëve (shihni pikat 4.3 dhe 5.7 më poshtë). **[RVV fq.18] [Kapitulli III Standardi VII.6]**
- 2.15 Kampusi është modern, i qetë, i mirëmbajtur dhe ndodhet larg vendeve industriale. Biblioteka është vendosur në bodrumin e godinës, në dy anët e një korridorit kryesor (shihni edhe pikën 5.5 më poshtë). Auditorët janë të izoluar nga zhurma, kanë temperaturë të kontrolluar dhe janë të mirëpajisur. Ata e plotësojnë normën e përdorimit të hapësirës përtej kërkesave minimale. Certifikimi kundër zjarrit dhe higjienës rinovohet përpara fillimit të çdo viti akademik. **[49.1]** Sistemi qendror i ngrohjes dhe ftohjes krijon një ambient të rehatshëm për mësimdhënie, mësimnxënie dhe kërkim. UNYT-ja ka gjeneratorë dhe depozita uji në rast mungese të energjisë elektrike ose të ujit. Ambientet mësimore janë të përshtatshme dhe të mrëpajisura. Godina ka një pamje moderne, elegante dhe të përshtatshme për biznes. Tabelat e njoftimeve janë vendosur në mënyrë strategjike në të gjithë godinën dhe përmbajnë njoftime të dobishme, duke përfshirë përdorimin e ambienteve sportive, hollësitë e ceremonisë së diplomimit dhe një shpërbllim financiar për studentin më të mirë. **[M10]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi edhe një sërë ambientesh të tjera, si për shembull: laboratorin e informatikës me një kapacitet prej 24 vendesh; një sallë të madhe leksionesh me kapacitet prej 90 vetash, disa auditorë me përmasa mesatare me kapacitet 24 deri në 36 vetë; një kafene në terracë me karrige për 50 vetë; një mensë të brendshme me ndenjësë për 24 vetë; një

fushë sportive të mbuluar në një pjesë të ndërtesës, me një sipërfaqe artificiale të përdorur për futboll, volejball dhe basketboll; dhe zona e tavolinës së ping-pongut. Të gjithë auditorët kanë dërrasa të bardha dhe projektorë. Studentët thanë se i përdornin ambientet sportive dhe se ishin të kënaqur me to. **[M6; M10]** Ndërkohë që stafi drejtues ka zyra të veçanta, stafi akademik ka si zyrë vetëm departamentin, të përbërë prej gjashtë tavolinash dhe kompjuterash. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk vuri re dhoma të posaçme për kërkuesit apo qendrat kërkimore, dhe as dhomën e mjekut. Zyra e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e Marrëdhënieve me Studentët dhe Zyra e Karrierës ishin vendosur në një zyrë të hapur. Diskutimet konfidenciale zhvilloheshin në ambiente private në dhomat ngjitur. **[M10] [Kapitulli III Standardi V.1]**

2.16 I gjithë informacioni që lidhet me studentët, studimet e tyre dhe tarifat e shkollimit mbahet në një bazë të dhënash dixhitale, në sistemin e bazës së të dhënave Gnomon, i cili ruhet në një server vendas dhe në Athinë. Ky sistem përdoret për të ruajtur dosjet e të gjithë studentëve të UNYT-së. Dosjet përmbajnë hollësitë rreth aplikimit, pranimit, prezantimit, notave, përvojës së punës dhe certifikatës së diplomimit. **[93; 93.1; 93.2]** Studentët e përdorin këtë sistem për të parë notat, oraret e mësimit, mungesat dhe hollësitë financiare. Gjithashtu ata marrin edhe këshillim për të. **[78; 78.1; 94]** UNYT-ja e përdor teknologjinë e tij për të mirëmbajtur si shërbimet e informacionit të brendshëm, ashtu edhe shërbimet e informacionit të jashtëm, të cilat përditësohen vazhdimisht për të ruajtur trashëgiminë dhe memorien institucionale. Gjithashtu, arkivohen kopjet e shtypura të të gjitha veprimtarive thelbësore akademike, të cilat rregullohen me një dokument politike. **[22.3] [Kapitulli III Standardi V.2]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e një politike për ngritjen në detyrë (pika 2.3; **Kapitulli III Standardi IV.3**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- marrja e menjëhershme e masave nga UNYT-ja për hartimin dhe zbatimin e një politike të plotë për ngritjen në detyrë (pika 2.3; **Kapitulli III Standardi IV.3**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Misioni i UNYT-së është t'iu ofrojë studentëve mundësinë për marrjen e një diplome universitare të nivelit Bachelor, Master ose doktorate në një shumëllojshmëri specializimesh akademike dhe profesionale, që do t'iu ofrojnë atyre njohuritë, aftësitë,

transparencën dhe besimin e nevojshëm për arritjen e suksesit në një ambient pune të larmishëm e ndërkombëtar, si dhe do t'i përgatisin për jetën si qytetarë produktivë e kontribues të komunitetit ndërkombëtar. [3 fq.2] UNYT-ja ofron programe studimi në të tre ciklet e studimit. Ai ofron informacion për publikun dhe studentët e ardhshëm në lidhje me programet e studimit përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, të tilla si faqja e internetit, takimet ballë për ballë, ditët e hapura, kontaktet e drejtpërdrejta me drejtorët e shkollave të mesme dhe vizitat në shkollat e mesme. [<http://unyt.edu.al/programs/>; 50; 5.1; M6] Të gjitha mjetet e përdorura janë plotësuese dhe sigurojnë informacion të saktë në lidhje me programet e studimit. UNYT-ja ofron programe studimi në Ekonomi dhe Administrim Biznesi, Shkenca Humane dhe Shoqërore, si dhe Shkenca Kompjuterike. Ai ka krijuar profilin e tij sipas misionit, dhe programet e tij të studimit janë të njëjta me nevojat e tregut të punës. [51.1, 51.2; 51.3; M2] [Kapitulli I Standardi I.1]

- 3.2 UNYT-ja zbaton procedura aplikimi dhe kriteret pranimi të qarta për studentët shqiptarë dhe të huaj, të cilat miratohen nga Senati Akademik. Proceset dhe kriteret e pranimit publikohen në faqen e internetit të UNYT-së. Gjithashtu, universiteti ka vendosur kriteret shtesë për pranimin dhe regjistrimin. Senati akademik ka vendosur të pranojë vetëm studentë me notë mesatare mbi 6.5, gjë që është mbi kriteret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. [32.1.1; 32.1.2; 32.1.2; C9.1; C9.2; <http://unyt.edu.al/admissions/undergraduate/application-process>] Këto kriteret janë lehtësisht të arritshme për studentët e ardhshëm, pasi janë të përfshira në materiale promocionale, [60; 60.1] të deklaruara në Ministrinë e Arsimit dhe agjencitë e saj, dhe të botuara në faqen e internetit të UNYT-së [<http://unyt.edu.al/admissions/undergraduate/application-process/>] si dhe në portalin U-Shqipëri. Programet e studimeve organizohen me qëllim integrimin e të gjithë komponentëve të përcaktuar në qëllimet dhe objektivat e programeve. Rregullat e vlerësimit përcaktohen qartë në Statut dhe rregullore. [RVV f. 19; 02, neni 61, fq.27] [Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.6]
- 3.3 UNYT-ja ofron kurse afatshkurtra për specializime në një fushë të caktuar, plotësimin apo përditësimin e njohurive në formën e të nxënësve gjatë gjithë jetës, dhe trajtimin e nevojave të veçanta të grupeve të ndryshme të studentëve. Disa prej kurseve dhe seminareve afatshkurtra që ofron UNYT-ja janë mikroekonomia e konkurrueshmërisë, analiza e biznesit nëpërmjet pasqyrave financiare, ngritja e një biznesi të vogël dhe valët e tregtisë. Ato ofrohen herë pas here në përgjigje të kërkesës së tregut. [52; 52.1; 52.2; 52.3; M13] Ligji për arsimin e lartë në Shqipëri nuk lejon studime me kohë të pjesshme. Megjithatë, institucioni i zhvillon orët mësimore të programeve të diplomimit pasdite ose në fundjavë, për t'iu përgjigjur nevojave të studentëve. [39; 53; 53.1, pika 2.5 fq. 6; 53.2, fq.23] UNYT-ja ka përcaktuar procedurat për vlerësimin e përvojës së fituar. UNYT-ja dhe Universiteti Shtetëror i "New York Empire State College" kanë zhvilluar mekanizma për transferimin e krediteve dhe akreditimin e të nxënësve eksperimental të mëparshëm. Numri i studentëve të transferuar në vitin akademik 2016-2017 është rritur me 53 për qind krahasuar me vitin e kaluar. [01, fq.5; 54; B3.1; B3.1.1; B3.1.2; B3.1.3; B3.1.4; B3.1.5] [Kapitulli I Standardi I.2]
- 3.4 Programet e studimit të ofruara nga UNYT-ja janë në pajtim me misionin e tij dhe strategjinë e zhvillimit institucional 2012-2017. [RVV fq.20] Kjo ilustron më së miri nga programi i integruar pesëvjeçar i studimit Master Shkencor në Drejtësi, i cili ofron një frymë të veçantë ndërkombëtare dhe tërheq studentë ndërkombëtarë, sipas objektivit strategjik të UNYT-së. [3, Objektivi Strategjik 4.1 fq. 9; 51.3] UNYT-ja synon të përmirësojë më tej ofertën e tij. Ai ka marrë në shqyrtim konkurrencën e universiteteve të tjera dhe synon të hapë programe të reja për sistemet e informacionit, psikologjinë, turizmin dhe ndoshta infermierinë. Ai shpreson të bashkëpunojë me partnerë ndërkombëtarë, si Universiteti i Tuluzës, për ofrimin e një programi studimi për hotelierinë. Gjithashtu, universiteti po planifikon hapjen e një fakulteti të tretë, në tetor të vitit 2017, për të qenë në përputhje me ligjin për statusin e universitetit. [M2; M4; M5] Kërkesat për kualifikimin e studentëve përputhen me objektivat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të UNYT-së. Për shembull, ai ka një komponent kërkimi që

përputhet me qëllimet e zhvillimit strategjik të të gjitha kurrikulave të UNYT-së. **[53.2 fq.43; 3 Qëllimi 1, fq.5]** Të gjitha programet e studimit integrojnë në mënyrë koherente informacionin rreth diplomave të lëshuara në përfundimin e studimeve. **[51.2 fq.4; 51.3] [Kapitulli I Standardi I.3]**

- 3.5 UNYT-ja ofron programe studimi në përputhje me prirjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, ai synon të përgatisë profesionistë të ardhshëm përmes mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit, duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe integritetit në komunitet, si dhe ofrimin të njohurive, aftësive, karakterit dhe besimit të nevojshëm për të arritur sukses në një mjedis të larmishëm ndërkombëtar. **[02 neni 1, fq.3]**. UNYT-ja i përditëson programet e veta dhe e rishikon kurrikulën, për sigurimin e aktualitetit dhe bashkëkohësisë së të gjitha programeve të tij të studimit. **[55; 55.1; 55.2]** Aspekti ndërkombëtar i programeve studimore sigurohet në disa mënyra: përmes mësimin në gjuhën angleze, emërimit të trupës pedagogjike ndërkombëtare, **[01 Seksioni F.1]** përzgjedhjes dhe përdorimit të teksteve ndërkombëtare, dhënies së krediteve pa pagesë për mësimin e gjuhëve të huaja, **[56; 56.1]** dhe dhënies së diplomave të dyfishta për studentët që vendosin të studiojnë me UNYT-në dhe një institucion partner, si me Universitetin Shtetëror të "New York Empire State College", Universitetin e Greenwich-it, ose Universitetin e Boltonit. **[RVV f.21; B3.2; B3.2.1; B3.2.2; B3.2.3; B3.2.4; C18.1; 18.2] [Kapitulli I Standardi I.4]**
- 3.6 Në fazën e hartimit të programeve të reja, UNYT-ja merr parasysh burimet e tij njerëzore, kapacitetet infrastrukturore dhe financiare. Për shembull, vendimi i institucionit për të hapur fakultetin e ri, atë të Informatikës, me qëllim ruajtjen e statusit të universitetit, **[24.1]** u parapri nga një studim realizueshmërie, i ndërmarrë nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike. **[57; M4; M5, RVV fq. 21]** Çdo vit, universiteti cakton ngarkesën e mësimore të pedagogëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj dhe rregulloren e institucionit. Ngarkesa mësimore e pedagogëve shpërndahet sipas orareve, ose për semestër, ose për vit, dhe përcaktohet në kontratat e anëtarëve të stafit me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. **[58 Shtojca 1]** Ngarkesa mësimore e stafit akademik me kohë të plotë ndryshon nga ngarkesa mësimore e kërkuesve. Ngarkesa mësimore e stafit akademik që ndërmerr kërkime, është më e vogël, e cila ndahet 56 për qind mësimdhënie dhe 44 për qind kërkime. Ngarkesa e tyre mësimore zakonisht zhvillohet gjatë një semestri, në mënyrë që të semestrin tjetër t'i përkushtohen kërkimit. Ngarkesa e stafit mësimdhënës ndahet në afërsisht dy të tretat mësimdhënie dhe një e treta kërkim. **[59; M12]** Gjithashtu, UNYT-ja punëson staf me kohë të pjesshme për plotësimin e nevojave shtesë të mësimdhënies. Shpenzimet e departamenteve për stafin plotësues me kohë të pjesshme mbulojnë nga buxheti kryesor. **[11.3; 58.1]** Raporti i përgjithshëm mes mësimdhënies, kërkimit dhe shërbimeve është i ekuilibruar dhe i përshtatshëm me pritshmëritë e ndryshme të stafit akademik dhe kërkimor të UNYT-së. **[07,6; 07.6.1]** Raportet vjetore përcaktojnë mënyrat që ndjekin departamentet dhe qendrat kërkimore për të negociuar me stafin akademik dhe kërkimor për caktimin e ngarkesës mësimore për vitin e ardhshëm akademik. **[RVV fq.21; 28; 28.1; 28.3]** Programet e studimeve organizohen në mënyrë të tillë që të lejojnë harmonizimin efikas të ngarkesës së mësimdhënies. **[B3.3.3; RVV fq.21] [Kapitulli I Standardi I.5]**
- 3.7 Informacioni për të gjitha programet e studimit vihet në dispozicion në faqen e internetit të Universitetit, si dhe publikohet në Manualin e Studentit. <http://unyt.edu.al/programs/bachelor-degrees/>; <http://unyt.edu.al/programs/graduate/>; <http://unyt.edu.al/programs/phd/>; **38; 53.2]** Universiteti iu shpërndan studentëve manuale dhe i diskuton me ta gjatë fazës së orientimit. Edhe format e shkurtuara të kurrikulës vihen në dispozicion në recepsionin e UNYT-së. Syllabuset iu shpërndahen studentëve në kopje të shtypura dhe elektronike gjatë javës së parë të mësimin. **[61]** Departamentet, fakultetet dhe Senati i përcaktojnë dhe i miratojnë programet e studimit, objektivat dhe rezultatet e të nxënies, në përputhje me rregulloret e UNYT-së. Të gjitha programet e studimeve Master i Shkencave kishin objektiva qartësisht të përcaktuara kur u miratuan, për të cilat studentët u shprehën se ishin më se të qarta (shihni edhe pikën 3.2 më sipër).

[M6; 51.1, fq.3; 51.2, fq.1; 51.3, fq.3] UNYT-ja ofron programe studimi të dyfishta, në fund të të cilave studentët marrin dy diploma (shini pikën 3.5 më sipër). Megjithatë, për të njëjtin program studimi, UNYT-ja lëshon një diplomë Bachelor Shkencor (Master Profesional në një fushë të caktuar) dhe institucioni partner, Universiteti Shtetëror i “New York Empire State College”, lëshon një diplomë Bachelor shkencor. **[01; B3.2; B3.2.3; C14.3; C14.1]** Bachelori shqiptar (Masteri Profesional) nuk garanton përfundimin e suksesshëm të ciklit të parë dhe pranimin në ciklin e dytë. Programet e studimit ofrohen si diploma të integruara në nivel Bachelor dhe Master Profesional dhe institucioni lëshon një diplomë të ciklit të dytë. Ligji Nr. 80/2015 për arsimin e lartë e konsideron programin Master Profesional si një program të ciklit të dytë, i cili duhet të ofrohet veçmas nga programi i studimeve të ciklit të parë (bachelor). Njohja e diplomës amerikane Bachelor si një diplomë shqiptare e nivelit Bachelor dhe Master Profesional konsiderohet si **dobësi**, pasi programet e studimit dhe objektivat e tyre nuk janë qartësisht të përcaktuara; në këtë rast janë të diferencuara në nivele të ndryshme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i **rekomandon** UNYT-së marrjen e menjëhershme të masave për riorganizimin e diplomës amerikane Bachelor dhe programet shqiptare të studimit në nivelin Bachelor dhe Master Profesional si programe të ciklit të parë dhe të dytë, dhe ofrimin e tyre veçmas. **[Kapitulli I Standardi I.6]**

- 3.8 Programet e studimeve Bachelor i pajisin studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për lehtësimin e përparimit në ciklin e dytë. Programet e studimeve janë projektuar për të mundësuar zhvillimin gradual të njohurive, aftësive dhe kompetencave. Për shembull, kurrikula në financë [<http://unyt.edu.al/programs/bachelor-degrees/finance/>] dëshmon një përparim të qartë të njohurive, aftësive, kompetencave dhe rezultateve të të nxënit. **[RVV fq.22; 38 fq.29]** Për të marrë një diplomë të integruar Bachelor dhe Master Profesional, nevojiten 128 kredite akademike, ndërsa për të marrë diplomën Master i Shkencave nevojiten 60 kredite akademike. **[69]** Informacioni për transferimin e krediteve publikohet në faqen e internetit të UNYT-së. [<http://unyt.edu.al/admissions/undergraduate/transfer/>] Zyra për Marrëdhëniet me Jashtë iu ofron studentëve informacion në lidhje me programet e shkëmbimit, mundësitë e transferimit dhe thirrjet për aplikime për mobilitet ndërkombëtar. **[1 Seksioni C; 42; <http://unyt.edu.al/applications-for-international-credit-mobility/>]** Programet e studimeve të ciklit të parë në UNYT i përgatisin studentët për tregun e punës dhe ofrojnë mundësi të ndryshme punësimi gjatë periudhës së studimit. Këtu përfshihen vizitat në terren, puna praktike dhe panairët e punës. Studentët konfirmuan rëndësinë e këtyre veprimtarive për t’u bërë pjesë e tregut të punës. **[M7; 61.1; 35.2; 61.2; 23.1; 23.2]** **[Kapitulli I Standardi I.7]**
- 3.9 UNYT-ja ka Qendrën e Mbështetjes Akademike, e cila monitoron dhe mbështet ecurinë e studentëve. Qendra ofron një sërë shërbimesh për të ndihmuar kalimin e studentëve nga shkolla e mesme në një mjedis universitar. Manuali i Studentit shërben si udhëzues referimi. **[38]** Në fillim të vitit akademik, UNYT-ja organizon seanca orientimi, me qëllim njohjen e studentëve me proceset dhe praktikatat e UNYT-së. **[62; M6]** Që në fillim të studimeve të tij, universiteti cakton një këshillues nga trupa pedagogjike për çdo student. **[92]** Ata duhet të konsultohen me këshilluesin e tyre të paktën një herë në semestër. Studentët konfirmuan rolin vendimtar të këshilluesve, pasi i ndihmonin në kalimin nga shkolla e mesme në universitet dhe nga universiteti në tregun e punës. **[63; M6]** UNYT-ja ka edhe një sistem të shërbimit të provës akademike për studentët e dobët, **[38, fq.67-68]** i cili monitorohet nga komisioni i ecurisë akademike. **[64]** Universiteti i referon studentët që hasin probleme të tjera të shërbimit e ndryshme mbështetëse. **[38, fq.72-75]** Gjithashtu, UNYT-ja organizon veprimtari për orientimin e studentëve, të tilla si: ditët e orientimit, seminarët për të saporegjistruarit, ditët e hapura për shërbimet ndaj studentëve dhe panairi i gjuhëve të huaja. **[62; 65; 42; 42.1]** Universiteti e përshtat shpërndarjen e kurrikulës sipas nevojave individuale për lloje të ndryshme studentësh, duke përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara si p.sh. me dëmtime në shikim. **[1, Seksioni H.1; 60.3 pika 5 e politikës së përgjithshme; M6; M7]** Numri i studentëve në klasë është mesatarisht 25 deri në 30. Kurrikula ofrohet nga anëtarët e stafit me kohë

të plotë dhe me kohë të pjesshme, që janë rekrutuar në bazë të meritës së kualifikimeve të tyre, përvojës në mësimdhënie dhe rezultateve të kërkimit (shihni pikën 2.1). Trupa pedagogjike me kohë të plotë dhe kërkuesit mbulojnë të paktën 70 për qind të kurrikulës. **[B3.3.1; B3.3]. [Kapitulli I Standardi I.8]**

- 3.10 Programet e studimeve të ciklit të dytë janë hartuar dhe ofrohen nga stafi kërkimor aktiv që ka titull doktorate. **[RVV fq.23; 18.2]** Për shembull, një nga kërkuesit e UNYT-së, që kohët e fundit mori fonde për zhvillimin e moduleve Zhan Mone në UNYT, ka kontribuar në kurrikulën universitare dhe pasuniversitare. **[66]** Gjithashtu, studentët përfshihen në projekte kërkimore, **[9.1]** dhe në përfundim të studimeve të tyre kërkohet që ta përgatisin temën e masterit në përputhje me Shtyllat e Kërkimit të UNYT-së. **[72]** Komunitetet e biznesit dhe ato profesionale kontribuojnë në hartimin e kurrikulës dhe në rishikimin e programeve studimore të UNYT-së. **[45; 55.1; 31; M8]** UNYT-ja punëson pedagogë me kohë të pjesshme për të sjellë në klasë njohuri të reja nga industria dhe komunitetet profesionale. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua rreth shembujve të propozimeve të tyre në fushën e financës dhe marketingut, që ishin pranuar. **[RVV fq.23; M8]** Universiteti mbledh të dhëna statistikore rreth punësimit të të diplomuarve. Statistikat e Zyrës së Karrierës dhe Alumni tregojnë se lidhjet e UNYT-së me komunitetin profesional kontribuojnë në normat e punësimit të të diplomuarve. **[RVV fq.23; 68]** Një pjesë e stafit me kohë të pjesshme, japin mësim në UNYT duke synuar identifikimin dhe rekrutimin e talenteve të reja. **[M8]** Mbi 70 për qind e programeve të ciklit të dytë ofrohen nga trupa pedagogjike me kohë të plotë. **[B3.3.3] [Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.11 UNYT përdor sistemin amerikan të krediteve për të gjitha programet e studimit. Sistemi është i konvertuar sipas standardeve të Bolonjës. **[RVV fq.24; M6]** Programet e studimit japin informacion rreth strukturës së programit, siç janë orari i kurseve, politika e klasifikimit dhe kreditet sipas sistemit amerikan. Hartimi i programeve të studimeve lejon dhe lehtëson transferimin e krediteve në universitete të tjera. **[53.1; 53.2]** Pas diplomimit, studentët marrin diplomën dhe një listë notash, që paraqet me hollësi sistemin e notave të UNYT-së, përkufizimin e krediteve dhe ekuivalencën e tyre në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). **[69]** Në fund të studimeve të tyre, të diplomuarit marrin edhe një suplement diplome. Kjo e fundit përmban informacion në gjuhën shqipe dhe angleze. **[69.1]** Një ish e diplomuar u shpreh se pas përfundimit të studimeve të ciklit të parë në UNYT, kishte arritur të merrte me sukses një diplomë të huaj Master. **[M8]** Një nga kërkesat e pranimit është zotërimi i gjuhës angleze me një rezultat të barabartë ose më të madh se 550. UNYT-ja e pranon TOEFL-in si provimin e gjuhës së huaj angleze, por pranon edhe çdo provim të barasvlershëm me të. **[32.1.2]** UNYT-ja ndjek një politikë për transferimin e krediteve, e cila mundëson transferimin e krediteve brenda ose jashtë vendit. Ai ndjek edhe një politikë për transferimin e gjuhës së huaj. UNYT-ja nxit studentët e tij ndërkombëtarë të mësojnë gjuhën shqipe për t'u integruar sa më mirë në Shqipëri. Studentëve joshqipfolës mund t'iu ofrohen kredite për gjuhën shqipe si gjuhë e huaj. **[54; 56.1; 56.2] [Kapitulli I Standardi I.10]**
- 3.12 Programet e studimit synojnë të vendosin në ekuilibër teorinë dhe praktikën përmes mbështetjes së leksioneve me ushtrime praktike dhe orë laboratorike. Gjithashtu, studentët vendosen në mjediset reale të botës së biznesit përmes praktikave dhe/ose projekteve, që lidhen me probleme reale. Moduli i sipërmarrjes dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është hartuar në mënyrë të tillë që t'i pajisë studentët me njohuritë bazë praktike, për bizneset e reja ose ekzistuese. **[RVV fq.24; 61.2; 61.3]** Fundjavat e bizneseve të reja i ofrojnë studentëve më shumë mundësi për të kombinuar njohuritë teorike me praktikën. **[70; 70.1; 70.2; M1]** UNYT-ja organizon veprimtari kulturore, sociale dhe edukative jashtë klase dhe studentët kanë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme komunitare. **[RVV fq.24; 11.5; 43; 71] [Kapitulli I Standardi I.11]**
- 3.13 UNYT-ja i përgatit studentët për punësim, nëpërmjet, për shembull, moduleve të veçanta, veprimtarive për zgjerimin e të nxëniet, panairëve të karrierës, praktikave, si dhe temave apo projekteve të konsulencës, që trajtojnë probleme reale. **[RVV fq.24; 61.2;**

61.3; 23.3; 23.1] Studentët e kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale ose stazhit. Praktikën i vendosin studentët në kushtet e punës së një biznesi apo institucioni. Ata kanë pritshmëri qartësisht të përcaktuara nga rezultatet e të nxënies, veprimtaritë dhe vlerësimi. **[B1.8.1-B1.8.4]** Studentët përgatisin një raport përfundimtar, i cili përshkruan organizatën pritëse, analizon mësimet e përfutuara gjatë praktikës, dhe paraqet reflektimet personale dhe këshillat për praktikantët e ardhshëm. Raporti dorëzohet në orën e fundit të modulit përkatës. **[B1.8]** UNYT-ja ka lidhur marrëveshje me organizata të sektorit publik dhe privat, që ofrojnë praktika dhe mundësi stazhi (shihni edhe pikën 1.14 më sipër). **[RVV fq.24; 35; 35.2] [Kapitulli I Standardi I.12]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- njohja e një diplome amerikane Bachelor si diplomë shqiptare e nivelit Bachelor dhe Master Profesional, pasi programet e studimit dhe objektivat e tyre nuk janë qartësisht të përcaktuara, dhe në këtë rast janë të diferencuara në nivele të ndryshme (pika 3.7; **Kapitulli I Standardi I.6**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- marrja e menjëhershme të masave nga UNYT-ja për riorganizimin e diplomës amerikane Bachelor dhe programeve shqiptare të studimit në nivelin Bachelor dhe Master Profesional, si programe të ciklit të parë dhe të dytë, dhe ofrimin e tyre veçmas (pika 3.7; **Kapitulli I Standardi I.6**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 UNYT-ja i zbaton në mënyrën e duhur programet e ofruara të studimit. Ai i organizon studimet siç parashikohet në Statutin e tij dhe i dokumenton ato në Manualin e Studentit, në orare të ndryshme, në faqen e internetit dhe në programet individuale. **[RVV fq .25; 02, nenet 50-54; 38, 6.3; 39; <http://unyt.edu.al/>; 61]** Universiteti e menaxhon në mënyrë të përshtatshme ngarkesën mësimore të personelit, duke vendosur në ekuilibër mësimin, kërkimin dhe administrimin. Për shembull, stafi i qendrës kërkimore, dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve përjashtohen nga ngarkesa mësimore, për të përmbushur detyrat e tyre në kërkim dhe drejtim. **[RVV fq.25]** Të gjithë anëtarët e

personelit kanë kontrata dhe/ose përshkrime të pozicioneve të punës. [RVV fq.25; 7.5; 7.6; 7.6.1; 58; 58.1] Personeli i UNYT-së mbikëqyr projektet e përgjithshme, praktikat, projektet e nivelit të lartë, projektet e konsulencës dhe punën kërkimore në të gjitha nivelet dhe fazat, siç përshkruhet në programet e kursit dhe specifikimet e programit. [RVV fq.25; 51; 51.1; 51.2; 51.3; 61; 61.1-61.7, veçanërisht 61.2 dhe 61.4] Gjithashtu, mbikëqyret përgatitja e projekteve të nivelit të lartë, të tilla si mikroteza në Bachelor dhe teza përfundimtare në Master. [61; 61,2, 61,5; 72] Biblioteka siguron literaturën e duhur mbështetëse (shihni pikën 5.5 më poshtë). [Kapitulli I Standardi II.1]

- 4.2 Studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi pajisen me diplomën përkatëse, e cila është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. [RVV fq.25; 38, fq. 59; 74] Përpara vlerësimit përfundimtar të diplomës, studentët duhet të kenë përfunduar një sërë vlerësimesh të tjera. Në kurrikul përshkruhen format e vlerësimit përmbledhës dhe formues. Zgjedhja e formave që do të përdoren lihet në dorën e vetë pedagogut, sipas frymës së autonomisë akademike, por nën mbikëqyrjen e departamenteve. Këto forma vlerësimi publikohen në kurrikulat [51.1; 51.2] dhe në syllabuset e kursit. [61] Në protokollin e provimeve nuk përfshihet anonimiteti. [RVV fq. 26; 14.2, fq.75-58; Sqarime 4.7] Megjithatë, paanshmëria dhe krahasueshmëria e vlerësimit me notë sigurohet me anë të mostrave të rastësishme nga ana e përgjegjësve dhe auditeve të departamenteve, që kryhen çdo semestër. [76; 76.1; Sqarime 4.5 dhe 4.7; B4.5.1; M4; M5] Kodi i Etikës së Studentit përfshin politikën e UNYT-së për kopjimin dhe plagjiaturën. [75] UNYT-ja ka një procedurë për ankimimin e studentëve, e cila përshkruhet në Manualin e Studentit, ku përfshihen edhe ankimimet kundër pikëve të provimit. Ankimimi trajtohet fillimisht nga Përgjegjësi i Departamentit (sipas rastit) dhe më pas nga Komisioni Akademik i Ankimeve. [RVV fq.26; 38 7.10, fq.69; 77] Pedagogët ua komunikojnë rezultatet e provimeve studentëve individualisht, dorazi në klasë, ose publikojnë një listë me rezultatet ku studentët identifikohen me numër dhe jo me emër. Notat e provimeve të ndërmjetme dhe atyre përfundimtare regjistrohen në mënyrë elektronike, të cilat mund të aksesoren nga studentët në mënyrë konfidenciale në sistemin e informacionit. Provimet përfundimtare dhe lëndët përfundimtare ruhen në Zyrën e Arkivës. [RVV fq. 26; 78; 78.1; M6] [Kapitulli I Standardi II.2]
- 4.3 UNYT-ja siguron përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të tij. Ai ka një larmi mekanizmesh që lehtësojnë kontrollin e cilësisë dhe përmirësojnë shërbimin e ofruar. Ai monitoron rregullisht performancën e pedagogëve përmes një sërë vlerësimesh, duke përfshirë vlerësimet nga studentët, vlerësimet nga kolegët, vlerësimet e performancës së fakultetit dhe vlerësimet e departamenteve në raportet vjetore për mësimdhënien, mësimnxënien dhe standardet e cilësisë që lidhen me to. [RVV fq.26; 17.1; 17.1.1; 17.2; 17.2.1; 17.3; 28.1, J, fq.7-10] Të gjitha kurset vlerësohen çdo semestër, ndërsa ato që jepen nga profesorët e rinj vlerësohen dy herë brenda semestrit. [Sqarimet 4.9; B4.9.1; M6; M7; M13] Krahas vlerësimeve të kurseve, studentët japin feedback-un e tyre përmes Anketimit të Studentëve në prag diplomimi dhe gjatë mbledhjeve të Këshillit Akademik. [RVV fq.26; 79; 19.7] Gjatë rishikimit të kurrikulës, merren parasysh rezultatet e vlerësimit nga personeli dhe studentët. Stafi akademik dha shembuj të ndryshimit të moduleve të tyre për të përfshirë më shumë zgjidhje problemesh dhe më shumë punë praktike. [55.1; M13] Feedback-u dhe të dhënat statistikore nga bizneset dhe komunitetet, ku janë punësuar të diplomuarit e UNYT-së, [68] nuk merren sistematikisht për bazë në rishikimin e kurrikulës. Megjithatë, UNYT-ja angazhon staf me kohë të pjesshme nga komuniteti i biznesit në Komisionin e Rishikimit të Kurrikulës dhe organizon tryeza të rrumbullakëta me biznesin. [Sqarimet 4.2; B4.2.3; M3; M11] UNYT-ja ka krijuar një bazë të dhënash për punësimin e studentëve në Zyrën e Karrierës dhe Alumnit. Gjithashtu, ai ka ngritur një bord këshillimor, të përbërë nga përfaqësues të kompanive dhe figura të shquara akademike e politike, por bordi këshillimor nuk është mbledhur. [Sqarimet 4.2; B4.2.1; B4.2.2; M3; M4; M5] [Kapitulli I Standardi II.3]
- 4.4 UNYT-ja ka një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies

është Zyra e Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve. Vlerësimet e personelit dhe programet përmenden në paragrafin e mësipërm. Masa të tjera shtesë përfshijnë seminare për zhvillimin e trupës pedagogjike, rishikimet e syllabusit dhe mentorimet. [RVV fq.27; 02; 8; 16; 14.3; 55.2; M4; M5; M13; M14] Manuali i Sigurimit të Cilësisë është një dokument tejet i dobishëm. [8]. Ai përfshin: kuadrin e sigurimit të cilësisë, sigurimin e cilësisë së personelit, procedurat e miratimit, monitorimin dhe shqyrtimin periodik të programeve, si dhe një përmbledhje të veprimtarive kryesore të ndërmarra nga organet e sigurimit të cilësisë në UNYT për periudhën 2015-2016. Në mësimdhënie dhe mësimnxënie, UNYT-ja ka investuar në krijimin e një bibliotekë ku titujt gjenden në format të shtypur, dhe në një tjetër elektronike. [RVV fq.26] Pedagogët e UNYT-së e kanë bërë punën praktike pjesë të kursit të menaxhimit ndërkulturor, dhe projekti i kërkimit shkencor në botën reale mund të jetë një risi e veçantë. [61.6; 61.7] UNYT-ja ka krijuar një laborator, i cili mund të funksionojë si një inkubator biznesi. [RVV fq.27] Pavarësisht se faza e parë ishte në muajin mars të vitit 2014 dhe afati i fundit për vënien në punë ishte janari i vitit 2016, [81, WP5, 5.1 dhe WP7, 7.1; M1] ende nuk ka prova për funksionimin e një inkubatori biznesi. [M10] UNYT-ja nxit rritjen e kualifikimeve të stafit akademik në mësimdhënie dhe kërkime, përmes mbështetjes së pjesëmarrjes në konferenca, sigurimit të lejeve të paguara për stafin për të marrë pjesë në veprimtari kërkimore jashtë vendit, sigurimit të mobilitetit për stafin përmes projekteve Erasmus + dhe mbajtjes së leksioneve të hapura në universitet. [80; 18; 18.1; 44] [Kapitulli I Standardi II.4]

- 4.5 Njësitë akademike bazë të UNYT-së janë departamentet dhe qendrat kërkimore. Personeli i të dyja këtyre njësive ndajnë të njëjtën zyrë, prandaj për qendrat nuk ka asnjë ambient fizik. Departamentet dhe qendrat kërkimore mbikëqyren nga përgjegjësit dhe drejtuesit, të cilët mbajnë përgjegjësinë kryesore për veprimtaritë kërkimore shkencore, megjithëse stafi i të dy njësive jep mësim rreth dhe ndërmerr kërkime. [RVV fq.27; 02, nenet 23, 27-33, 39 pika 5; 04,1; 28.1; 28.3; B4.4; Sqarime 4.3; B4.3; M10; M12] Raportet vjetore të departamenteve nuk nxjerrin në pah në mënyrë specifike pikat e forta dhe të dobëta në fushën e kërkimit shkencor. Ai nuk ka asnjë seksion të veçantë për kërkimin, pavarësisht se vëren, te dobësitë, "se kërkimet ndërmerren në shkallë të vogël" [28.1, fq.3] dhe i rendit arritjet e kërkimit në tabelat e raporteve individuale, që përmbajnë pikat e veprimit individual. [28.3] Ekziston edhe një listë veprimtarish, që përmban disa pika veprimi të vjetruara dhe një listë të rezultateve kërkimore, por nuk identifikon pikat e forta apo të dobëta. [B4.4] Fakti që departamentet nuk nxjerrin në pah pikat e tyre të forta dhe të dobëta në fushën e kërkimit shkencor konsiderohet si **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** marrjen e menjëhershme të masave, në mënyrë që të gjitha departamentet e UNYT-së të nxjerrin në pah pikat e tyre të forta dhe të dobëta në fushën e kërkimit shkencor, duke hartuar plane realiste për maksimizimin e pikave të forta dhe minimizimin e atyre të dobëtave. Departamentet dhe qendrat kërkimore ia paraqesin kërkesat e tyre financiare Zyrës së Financës, e cila harton buxhetin. Në financimin e grupeve kërkimore përfshihen kryesisht qendrat kërkimore, por kërkimet mund të financohen edhe nga departamentet. [11.3, 2.1, F1] Qendrat kërkimore i mbikëqyrin nga afër kërkimet, me pika veprimi për çdo anëtar, por departamentet ndonjëherë shënojnë vetëm veprimtaritë e stafit, pa pikat e veprimit. [28.1; 28.3] Stafi akademik dhe kërkimor angazhohen në mbështetjen e misionit të përgjithshëm dhe zhvillimin strategjik të UNYT-së. Rinovimi apo ndërprerja e kontratës përcaktohet nga vlerësimet e fundvitit. [RVV fq.28] [Kapitulli II Standardi I.1]
- 4.6 UNYT-ja nxit zhvillimin, dinamizmin dhe kërkimin shkencor. Ai mbështet nisma të reja kërkimore, në veçanti ato me natyrë ndërdisiplinore. Ato mbështeten në tri mënyra: përmes punësimit të stafit akademik në qendrat kërkimore, përdorimit të doktorantëve dhe mbështetjes së projekteve kërkimore me përmasa të vogla, që premtojnë të transformohen në projekte më të mëdha me një fond të posaçëm buxhetor. [RVV fq. 28; 9; 9.1; 7.6; 7.6.1; M12] UNYT-ja ka krijuar partneritete me institucione të tjera, sfera e veprimtarisë e të cilave përfshin kërkimet shkencore, si p.sh Universiteti i Finlandës dhe Programi Rajonal i Ballkanit Perëndimor për Kërkimin Shkencor. Gjithashtu, ai merr

pjesë si partner në projekte të financuara nga subjekte të ndryshme të Bashkimit Evropian, si p.sh Qendra Evropiane dhe Mbrojtësit e të Drejtave Civile. [RVV fq.28; 9; 9.1; 10.1; 35; 37.1] [**Kapitulli II Standardi I.2**]

- 4.7 UNYT-ja përqendrohet në ndërkombëtarizimin e kërkimeve shkencore në një sërë mënyrash. Ai ka krijuar Zyrën për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin vitin e kaluar dhe Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë në muajin prill të vitit 2017. [RVV fq.28; 01 Seksioni C, f.3; 29; M2; M3] Krahas këtyre, në dhjetor të vitit 2016, universiteti themeloi Fondacionin UNYT për lehtësimin e paraqitjes së ofertave për projekte. [30] Zyra e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit ka aplikuar në disa oferta evropiane dhe këshillon stafin për procesin e tenderimit. [37.1; M12] UNYT-ja ka qenë 'mesatarisht aktive' [RVV f.28] në organizimin e konferencave ndërkombëtare. Në nëntor të vitit 2015 organizoi dy konferenca ndërkombëtare, [82; 82.1; 82.2; 86; M11] ndërsa në muajt e mëparshëm të këtij viti akademik, ka organizuar në bashkëpunim me partnerët një konferencë në Shkup [84] dhe po synon të organizojë edhe një konferencë tjetër ndërkombëtare nëpërmjet grantit Zhan Mone në të ardhmen. [37.2; 37.2.1; 37.2.2; 37.2.2.1] Stafi akademik mbikëqyr tezat e masterit dhe të doktoratës, disa prej të cilave përmbajnë kërkime ndërkombëtare. [83; 83.1] UNYT-ja ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi. Shumë prej tyre përqendrohen në stazhe (shihni pikën 1.4), [35] dërsa të tjerat janë më ndërkombëtare, siç janë ato me Institutin e Studimeve Politike të Rennes-it, Universitetin Herzing dhe Universitetin Teknik të Lindjes së Mesme. [10.1] Kërkuesit dhe stafi akademik i UNYT-së botojnë artikuj në revista akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, por Universiteti e pranon se, në revistat prestigjioze të recensuara nga kolegët, botimet e rezultateve kërkimore të stafit të tij nuk janë të mjaftueshme, të indeksuara dhe të referuara mirë. [RVV fq.28; 18.2] [**Kapitulli II Standardi I.3**]
- 4.8 UNYT-ja nuk ka prioritete kërkimi qartësisht të përcaktuara. Strategjia e tij Kërkimore është një dokument prej katër faqesh, që nuk përcakton prioritetet, por rendit katër "ambicie" të përgjithshme dhe "tregues të matshëm të objektivave", që nuk përmbajnë objektiva specifike të matshme. [9] Prioritetet e tij kanë të bëjnë me shtyllat e kërkimit dhe ekspertizën e stafit. Për shembull, shtylla e pestë e kërkimit e UNYT-së (integritet evropian, reforma dhe drejtimi) përputhet me ekspertizën e stafit dhe me një fushë prioritare evropiane. [RVV fq.29; 9.1; Sqarime 4.11; B4.11.1; B4.11.2; B4.11.3; B4.11.4; M12] Asnjëra prej "ambicieve" nuk paraqitet në raportet vjetore të departamenteve, dhe mënyra se si prioritetet ose shtyllat janë përcaktuar mbetet e paqartë (shihni pikën 4.5). Stafi përmendi disa prej prioriteteve të përgjithshme dhe konfirmoi se ato kishin lidhje me ekspertizën e tyre. [M12] UNYT-ja synon të hartojë një Plan Strategjik të ri për Zhvillimin Institucional për periudhën 2017-2022, ku do të referohen në veçanti fushat prioritare kërkimore, të cilat janë shfaqur tashmë, por kjo gjë është ende në fazë planifikimi. [RVV fq.29; 9.1; 31, Tema 5, pika 4] Mungesa e një vizioni të qartë me prioritete specifike për zhvillimin e ardhshëm të kërkimit shkencor konsiderohet si **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon UNYT-së marrjen e menjëhershme të masave për krijimin e një vizioni të qartë për zhvillimin e kërkimit shkencor në të ardhmen me objektiva specifike, të matshme, të realizueshme, të rëndësishme dhe me afate kohore të përcaktuara. [**Kapitulli II Standardi I.4**]
- 4.9 UNYT-ja investon burime në ndërmarrjen e kërkimeve. Qendrat e kërkimit punësojnë staf me përvojë kërkimore, që plotëson shtyllat ekzistuese të kërkimit. [Sqarimet 4.11; B4.11.1; B4.11.2; B4.11.3; B4.11.4; C2.1; C2.2; C2.3; C2.4; M3; M12; M13; M14] Doktorantët janë pjesë e stafit akademik dhe kërkimor, por nuk ka vende të posaçme që ata të mund t'i përdorin, krahas rasteve kur janë pedagogë të punësuar. [RVV fq.29; M11] Financimi për kërkime përbën 14 për qind të buxhetit vjetor të UNYT-së. [01; M2; B4.12; C3; M3; M4; M5; M11; M12] Këtu përfshihet plotësimi i numrit të anëtarëve të stafit, por duke qenë se edhe stafi kërkimor jep mësim, është e pamundur të përcaktohet se cila pjesë e kostos së stafit shkon për kërkimin dhe cila për mësimdhënien akademike. [C3] [**Kapitulli II Standardi I.5**]

